



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 706 Prot.

Tiranë, më 20 . 10 , 2015

V E N D I M

Nr 115 , datë 20/10 /2015

"Mbi përfundimin e procedurës administrative të mbikëqyrjes në lidhje me rekrutimet e përfshira në Vendimet nr. 76, datë 29.07.2015, nr. 77, datë 29.07.2015 dhe nr.79, datë 29.07.2015, të Komisionerit, me objekt zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, gjatë procesit të rekrutimit, në njësitë e integritit në ministritë e linjës"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjet tematike të filluara me Vendimet nr.76, datë 29.07.2015; nr. 77, datë 29.07.2015 dhe nr. 79, datë 29.07.2015, të Komisionerit, me objekt, zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil gjatë procesit të rekrutimit, në pozicione pune pjesë e njërive të integritit në ministritë e linjës",

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen tematike, me objekt zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, gjatë procesit të rekrutimit, në pozicione pune pjesë e njërive të integritit, në ministritë e linjës, si më poshtë:

- Vendimi nr. 79, datë 29.07.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, për pozicionet e punës "Specialist në Sektorin e Përafrimit të Legjislacionit", Drejtoria e Ligjeve të BE-së, në Ministrinë e Integritit Evropian; "Specialist në Sektorin për Programet në Fushën Ekonomike, Kohezionit Social dhe Bujqësisë", në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integritit Evropian; "Specialist në Sektorin e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transnacional", në Drejtorinë e Programeve Ndërkufitare dhe Transnacionale në Ministrinë e Integritit Evropian, "Specialist në Sektorin për Programet e BE-së, në fushën e Demokracisë, Qeverisjes, Zbatimit të Ligjit dhe të të Drejtave Themelore", në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integritit Evropian; "Specialist në Sektorin për Asistencën e BE-së, Monitorimin dhe Vlerësimin, në Drejtorinë e programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integritit Evropian";

- *Vendimi nr. 77, datë 29.07.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë procesit të rekrutimit, për pozicionet e punës "Përgjegjës i Sektorit të Projekteve IPA dhe donatorëve të tjerë", në Drejtorinë e Integritit Evropian dhe Projekteve, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave; "Përgjegjës i Sektorit të Projekteve IPA dhe koordinimit me donatorët", në Drejtorinë e Integritit Evropian dhe Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme; "Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Fondeve IPA dhe donatorëve të tjerë", në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Jetësimit të Prioriteteve të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Integritit, në Ministrinë e Drejtësisë; "Drejtor i Drejtorisë së Integritit Evropian dhe Programit IPA", në Ministrinë e Financave; "Drejtor në Drejtorinë e Integritit Evropian", në Ministrinë e Punëve të Brendshme;*
- *Vendimi nr. 76, datë 29.07.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë procesit të rekrutimit, për pozicionet e punës "Drejtor i Drejtorisë së Integritit Evropian" dhe "Drejtor i Drejtorisë së Projekteve", në Drejtorinë e Përgjithshme të Integritit, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës".*

Në përputhje me objektin e mbikëqyrjes tematike, nëpërmjet grupit të punës, u realizua ndjekja në vend e fazave të rekrutimit dhe konkretisht, testimi me shkrim si dhe intervista e strukturuar me gojë, gjatë procesit të ngritjes në detyrë, sipas publikimit në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, me dokumentin e shpalljes nr. 397; nr. 398; nr. 396; nr. 393; nr. 395; nr. 399; nr. 400, si dhe në të njëjtën mënyrë u realizua mbikëqyrja e procesit të rekrutimit për plotësimin e pozicioneve të punës në nivele ekzekutive, publikuar në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike me dokumentin e shpalljes nr. 402; nr. 404 dhe 405.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit u realizua në selinë e Shkollës së Administratës Publike (ASPA), ku u zhvillua edhe procesi i rekrutimit dhe në përfundim të tij, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar relacionin përkatës, i cili është miratuar nga Komisioneri.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u kryen një sërë veprimesh, në lidhje me njohjen dhe sqarimin e situatës për këto procese, të cilat kanë të bëjnë me komunikimin e vazhdueshëm shkresor dhe verbal me Departamentin e Administratës Publike, të materializuara në aktet e administruara në dosjen e mbikëqyrjes, ndër të cilat, shkresa nr. 579, datë 31.07.2015 "Kërkesë për dokumentacion", me anë të së cilës kërkohej vënia në dispozicion e dokumentacionit, pjesë e praktikës së procesit të rekrutimit.

Po kështu, vonesa në dërgimin e dokumentacionit nga ana e Departamentit të Administratës Publike, si dhe parregullsitë e konstatuara gjatë mbikëqyrjes në vend të procesit të testimit, sollën ndërhyrjen e Komisionerit, i cili vendosi pezullimin e procesit të rekrutimit, me Vendimin e ndërmjetëm nr. 85, datë, 31.07.2015, me qëllim që të sigurohej objektiviteti i konkurimit, duke respektuar procedurat ligjore për këtë institut të ligjit.

Më tej, pasi u mundësua verifikimi i dokumentacionit, i cili u dërgua nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 3838/1, datë 03.08.2015, ku pasqyrohej veprimtaria e strukturave të ngarkuara me ligj, deri në fazën që kishte arritur procesi, Komisioneri vlerësoi se parregullsitë e vërejtura deri në këtë fazë të hetimit administrativ ishin të karakterit formal dhe

nuk ishin të asaj natyre që të prekin thelbin e përmbajtjes së procesit të rekrutimit dhe për këtë arsye, urdhëroi revokimin e vendimit të pezullimit, me Vendimin nr. 86, datë 04.08.2015, për t'i hapur rrugë vijimit të mëtejshëm të procesit.

Më tej, pas kërkesës për t'u informuar në lidhje me ecurinë e mëtejshme të procesit, me shkresën nr. 4211/I prot., datë 11.09.2015, "*Informacion në lidhje me procedurat e konkurrimit në njësitë e integritetit në ministritë e linjës*", të Departamentit të Administratës Publike, Komisioneri ra në dijeni të faktit se, për shkak të parregullsive të konstatuara, është vendosur anulimi i procedurave të konkurrimit, objekt i mbikëqyrjes dhe rishpallja e tyre gjatë muajit shtator të vitit kalendarik në vijim.

Nga sa më sipër, konstatohet se objekti për të cilin kishte filluar mbikëqyrja, sipas vendimit nr.76, datë 29.07.2015, vendimit nr. 77, datë 29.07.2015 dhe vendimit nr. 79, datë 29.07.2015, tashmë është bërë i pamundur për t'u realizuar, për arsye se Departamenti i Administratës Publike, si institucioni përgjegjës për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, bazuar në nenin 7, pika 2/c, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ka vendosur anulimin e procedurave për konkurimet objekt i mbikëqyrjes dhe rishpalljen e tyre në një kohë tjetër.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedurës administrative të mbikëqyrjes tematike, filluar me Vendimin nr.76, datë 29.07.2015, Vendimin nr. 77, datë 29.07.2015 dhe Vendimin nr. 79, datë 29.07.2015, të Komisionerit, me objekt zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, gjatë procesit të rekrutimit, në pozicione pune pjesë e njësive të integritetit, në ministritë e linjës, për shkak të mungesës së objektit.
2. Të monitorohet në vijimësi procesi i shpalljeve për plotësimin e pozicioneve të punës që janë objekt i mbikëqyrjes në këtë rast dhe të merren masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për të planifikuar procesin e mbikëqyrjes, menjëherë pas shpalljes së tyre në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA